



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:141432
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05509704

PPP.nr.165/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, kundër debitorit Rr.S. nga Shtimja, rr "...", për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET si i paafatshëm prapësimi i debitorit Rr.S., i ushtruar kundër urdhrin për përmbartim P.nr.386/2022, të datës 22.06.2022, i lëshuar nga përmbartuesi privat B.A. nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.386/2022, i datës 22.06.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.386/2022, të datës 22.06.2022, përmbartuesi privat B.A., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a, kundër debitorit Rr.S., për pagesën e borxhit në shumë prej 1,797.40 euro, në bazë të ekstraktit nga librat afariste DFE ..., të datës 21.06.2022, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përmbartuesit privat, ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit, debitori ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe prapësimin e debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është paraqitur jashtë afatit ligjor të paraparë në nenin 70, të LPP-së.

Në nenin 70, të LPP-së, është paraparë se afati për paraqitjen e prapësimit kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit është 7 ditë, nga dita e pranimit të urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit dhe nga shkresat e lëndës, flet kthesës mbi dorëzimin e urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit nga përmbaruesi privat, gjykata konstatoj se debitori urdhrin mbi lejimin e përmbarimit e ka pranuar me datë 27.06.2022 ndërsa prapësimin e ka dorëzuar në zyrën e përmbaruesit privat me datë 05.07.2022, që nënkupton se debitori prapësimin e ka dorëzuar jashtë afatit ligjor prej shtatë (7) ditëve, brenda të cilit ka pasur të drejtën e tij ligjore që ta ushtroj prapësimin kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit, në pajtim me nenin 70, të LPP-së.

Për më tepër në dispozitën e nenit 126.5, të LPK-së, është paraparë shprehimisht: “Kur dita e fundit e një afati bie në ditë feste shtetërore apo ditën e diel ose në ndonjë ditë tjetër kur nuk punon gjykata, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas asaj të pushimit”

Andaj, Gjykata bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.165/22, më datë 27.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.